

PROCESVERBAL
Nga Kuvendi i Shtatë i Komunitetit Shqiptar të Gjenevës,
i mbajtur me 26 qershor 2022 në Gjenevë, në sallën AstrOnex në Onex

Prezent, anëtarët e kryesisë: Fadil Avdija, Nebi Hyseni, Afërdita Krasniqi, Lutfi Rexha, Blerim Ibrahimimi, Lah Jashari dhe Nasuf Nuhiu. Mungojnë Ali Mehmeti, Fadil Selmani dhe Arbërie Fejzi

Po ashtu në sallë janë të pranishëm edhe rreth 30 persona tjerë, anëtarë të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës.

Mbledhjen hapi kryetarja e Komunitetit Shqiptar të Gjenevës (KShGj) znj. Afërdita Krasniqi duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke propozuar rendin e ditës që u ishte dërguar anëtarëve të KShGj-së tre javë përpara me postë elektronike:

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga Kuvendi i fundit;
2. Paraqitja e raportit të punës për periudhën ndërmjet dy kuvendeve, diskutimi dhe aprovimi;
3. Paraqitja e Bilancit financiar për vitet 2019, 2020 dhe 2021 paraqitja e raportit të verifikuesve të kontos për të njëjtat vite, diskutimi dhe aprovimi;
4. Zgjedhja e verifikuesve të kontos për vitin 2022;
5. Përcaktimi i anëtarëve të kryesisë pas tërheqjes apo/edhe plotësimeve me anëtarë të rinj;
6. Përcaktimi i lartësisë së anëtarësisë
7. Vazhdimi i mandatit të Kryetarit/ës të KShGj-së
8. Të ndryshme

Ky rend dite u aprovua njëzëri dhe u kalua në pikën e parë.

1. Aprovimi i procesverbalit nga Kuvendi i Gjashtë

Procesverbali nga Kuvendi i Gjashtë i është dërguar të gjithë anëtarëve të KShGj-së paraprakisht ashtu që kanë pas mundësinë ta lexojnë më herët. Nuk pati asnjë vërejtje, ashtu që PV u aprovua njëzëri.

2. Paraqitja e Raportit të punës, diskutimi dhe aprovimi

Kryetarja e KShGj znj. Afërdita Krasniqi, paraqiti raportin e punës që përfshin periudhën ndërmjet dy kuvendeve. Kjo periudhë ishte pak më e gjatë, për shkak të pandemisë, respektivisht nga 5 maji 2018 gjer më 31 dhjetor 2021. Anëtarëve të komunitetit i u është dërguar paraprakisht me postë elektronike ashtu që kanë pasur mundësinë ta lexojnë më herët. Nuk pati asnjë vërejtje dhe Raporti i punës u aprovua njëzëri.

3. Paraqitja e raportit financiar, diskutimi dhe aprovimi

a) Arkëtari, Nasuf Nuhiu, paraqiti Raportin financiar për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Anëtarëve të komunitetit i u është dërguar paraprakisht me postë ashtu që kanë pas mundësinë ta shikojnë më herët. Nuk pati asnjë vërejtje dhe raporti u aprovua njëzëri.

b) Verifikuesit e kontos, të emëruar në Kuvendin e fundit, paraqitën raportin e kontrollit, të shkruar dhe nënshkruar për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Njëri nga ata, Ilir Sahiti e lexoi raportin e kontrollit duke konstatuar se raporti financiar është në përputhje me Statutin e shoqatës dhe ligjin, prandaj i propozuan Kuvendit ta aprovojnë.

Raporti u aprovua njëzëri.

4. Zgjedhja e verifikuesve të kontos për vitin 2022

Për verifikues të kontos janë propozuar nga publiku z.Ilir Sahiti, z.Rifat Haxhiu dhe z.Shaip Deda. Propozimi u aprovua njëzëri.

5. Plotësimi i kryesisë me anëtarë të rinj dhe delegimi nga shoqatat tjera (neni 16, pika g) e Statutit tonë;

Edhe pse ka disa shoqata që nuk kanë përfaqësues në KShGj ata nuk shprehen interesim ti bashkëngjiten KShGj-së.

Në krahasim me përbërjen e kaluar të kryesisë së KShGj nga anëtarët është tërhequr Lah Jashari dhe Arbërie Fejzi, kurse në këtë kuvend është propozuar dhe pranuar Rrezartë Sejdiu-Shatri, Linda Rexhaj-Maliqi, Blerim Bunjaku dhe Mergime Bajrami. Pra, anëtarët aktual të kryesisë së KShGj-së janë:

1. Afërdita Krasniqi,
2. Ali Mehmeti,
3. Fadil Avdiqja,
4. Fadil Selmani,
5. Rrezartë Sejdiu-Shatri,
6. Lutfi Rexha,
7. Nasuf Nuhiu,
8. Nebi Hiseni,
9. Linda Rexhaj-Maliqi,
10. Blerim Ibrahimimi,
11. Blerim Bunjaku
12. Mergime Bajrami

6. Përcaktimi i lartësisë së anëtarësisë,

Edhe pse ka pasur diskutime dhe mendime të ndryshme, megjithatë u vendos me shumicë votash që anëtarësia të mbetet 100fr në vit për familje. Përfundim bëjnë familjet që janë në asistencë sociale, personat në pension invalidor dhe studentët që janë në Gjenevë pa familje; anëtarësia për ata do të mbetet 20fr në vit.

7. Vazhdimi i mandatit të Kryetarit/ës të KShGj-së

Duke pasur parasysh se funksioni i Kryetarit/ës nuk ka mund të ushtrohet për shkak të situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar nga virusi covid-19 dhe pandemia e shpallur, Kryesia e KShGj-së ia ka propozuar Kuvendit që mandati aktual të zgjatet për dy vite të tjera, respektivisht deri në vitin 2023. I njëjti parim vlen edhe për sekretarin dhe arkëtarin.

Propozimi u aprovua njëzëri.

8. Të ndryshme

Nuk pati asnjë ndërhyrje në këtë pikë.

Pas përfundimit të punimeve të pranishmit vazhduan shkëmbimin e mendimeve të përcjell me një aperiitiv.

Në Gjenevë, 26.06.2022

Procesmbajtëse
Mergime Bajrami

Kryetare e Komunitetit Shqiptar të Gjenevës
Afërdita Krasniqi